



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2183 Prot.

Roskovec, më 26.03 2024

**V E N D I M**

Nr. 21, datë 25/03/2024

**“ PËR MIRATIM FONDI PËR PROJEKTIN “KOMPLEKSI I TERENEVE SPORTIVE TË HAPURA**

**DHE TË MBYLLURA NË SHKOLLËN “5 DËSHMORËT”, SUK 1”**

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar, neni 9, pika 1.3 gërma c, dhe neni 54 pika dh, të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjen vendore“ neni 45, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" i ndryshuar neni 44, paragrafi II, gërma a, të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të VKB nr.109 datë 21.12.2023 “Për miratimin e buxhetit, numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe ndërmarjeve vartëse për vitin 2024”, shkresës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr.1815/3 prot. datë 11.03.2024, si dhe relacionit të Drejtorisë së Urbanistikës, Këshilli i Bashkisë,

**-VENDOSI :**

- I. Të miratohet fondi prej 49,847,216 lekë për objektin : “Kompleksi i tereneve sportive të hapura dhe të mbyllura në shkollën “5 Dëshmorët” Suk 1, nga i cili 42,370,134 lekë financim nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe 7,477,082 lekë bashkëfinancim nga të ardhurat e bashkisë.

Për kontributin e bashkisë Roskovec :

**1. NJËSIA SHPENZUESE "BASHKIA ROSKOVEC", KODI 2113001**

NR	GR	TIT	KAP	ART	EMËRTIMI I PROGRAMIT BUXHETOR	EMËRTIMI I OBJEKTIT/SHPENZIMIT	Shuma objektit	2024	2025
1	00	08130	5	231	Sport dhe Argëtim	Kompleksi i tereneve sportive të hapura dhe të mbyllura në shkollën “5 Dëshmorët”, Suk 1	7,477,082	0	7,477,082
					<b>SHUMA:</b>		7,477,082	0	7,477,082

**II.** Ngarkohet Administrata e Bashkisë dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**

**Afrim Plaka**

